



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 7081 / Prot
1

Tiranë, më 2 /05/2017

Lënda: *Në lidhje me kërkesën për bashkëpunim*

Drejtuar: **Znj. Gentiana Sula**

Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Zyra e Komisionerit”) u njoh me shkresën tuaj, nr. 206 prot, datë 20.04.2017 dhe me rrethanat e parashtruara në të.

Paraprakisht, vlerësojmë ndërgjegjësimin dhe angazhimin tuaj në kuadër të garantimit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe respektimit të detyrimeve ligjore referuar Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar nga njëra anë dhe Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga ana tjetër, zbatimin e të cilave përbën dhe objektin e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.

E drejta e privatësisë është një e drejtë themelore kushtetuese që gëzohet nga çdo person, përfshirë këtu edhe ata që kandidojnë për të ushtruar ose ushtrojnë funksione publike.

Është e rëndësishme që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit, në cilësinë e kontrolluesit, në zbatimin e detyrimeve ligjore që i cakton Ligji 45/2015 për bashkëpunim dhe informimin e institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tyre, të respektojë të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, parimet e mbrojtjes së të dhënave personale (sanksionuar në nenin 5 të Ligjit 9887/2008) dhe të sigurojë që përpunimi i të dhënave të jetë i bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Referuar kërkesës suaj për vënien në dispozicion ose jo të Avokatit të Popullit të Vendimit të plotë të Autoritetit që ju drejtoni, në vlerësimin e kërkesës duhen mbajtur parasysh parimet e sanksionuara në shkronjat a) dhe c) të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në bazë të nenit 5, pika 1 shkronja a) mbrojtja e të dhënave personale bazohet në përpunimin në mënyrë të drejtë e të ligjshme. Shkronja c) sanksionon parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim. Ky parim është thelbësor në vlerësimin e kërkesës së Avokatit të Popullit.

Duke marrë në konsideratë interesin e lartë publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi (në kuadër të të cilit është paraqitur kërkesa), Vendimi mund të vihet në dispozicion të Avokatit të Popullit së bashku me pjesën përshkruese - arsyetuese duke fshirë pjesët të cilat do të cënonin sferën e privatësisë së personave të tretë të përmendur në të si dhe informacionin e klasifikuar sekret nga ana e Shërbimit Informativ të Shtetit.

Në lidhje me hartimin e programit të transparencës nga ana e institucionit tuaj, ju bëjmë me dije se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar dhe shpërndarë një model për programin e transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilin e gjeni në faqen zyrtare www.idp.al të Zyrës së Komisionerit. Megjithatë, ne mbetemi të gatshëm për t'ju ardhur në ndihmë për çdo paqartësi që mund të keni.

Sa i përket publikimit të Vendimeve të Autoritetit në kuadër të transparencës, duke pasur parasysh objektin e aktivitetit të institucionit që ju drejtoni, vlerësojmë se këto Vendime përmbajnë përgjithësisht të dhëna personale, e në disa raste edhe të dhëna sensitive, të cilat kërkojnë mbrojtje të posaçme. Në këtë këndvështrim, vlerësojmë se në publikimin e Vendimeve duhet zbatuar neni 17 i Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i cili liston rastet kur e drejta e informimit kufizohet. Një ndër këto raste është dhe ai kur bërja publike e një informacioni mund të çënojë të drejtën e privatësisë të personave të tretë të përmendur në Vendim.

Nëse konsideroni që këto vendime do të përmbanin të dhëna publikimi i të cilave do të cënonin sferën e privatësisë së personave të tretë, ato mund të vihet në dispozicion të publikut duke hequr pjesët që kufizohen në përputhje me nenin 17, pika 6 e Ligjit 119/2014.

Duke shpresuar të kemi qenë shterues në opinionin tonë, ju falenderojmë për bashkëpunimin.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

